



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 17. 10. 2019

VENDIM

Nr. 47, datë 17. 10. 2019

MBI PROPOZIMIN PËR LIKUJDIMIN E ORËVE SUPLEMENTARE

Mbështetur në nenin 49, pika 1/a, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr.29, datë 10. 09. 2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", referuar shkresës nr. 1241/1 prot, datë 08.10.2019 si dhe shkresave shoqëruese, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 17. 10. 2019,

VËREN SE:

Nga Administratori i Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë është sjellë për shqyrtim pranë sekretarisë së Bordit të Administrimit shkresa me nr. 1241/1 prot, datë 08. 10. 2019, me anën e të cilës kërkohen të paguhen orët suplementare nga 200- 300 dhe mbi 300 orë (si ngarkesë jashtë auditori), për vitin akademik 2018- 2019. Në relacion dhe në shkresat bashkëlidhur vihet re një tejkalim i orëve që parashikon udhëzimi dhe kjo për shkak të disa rasteve specifike të tilla si: rekrutim i stafit me vonesë, pedagogë që kanë qenë me leje lindje, pedagogë që janë shkëputur për arsye shëndetësore, mos përgjigje thirrjes për pedagogë të jashtëm, çeljen e kurseve të posaçme apo ngarkesa të paplanifikuara për shkak të hapjeve të programeve të reja të studimit apo riorganizimit të atyre ekzistuese.

Neni 2 i Udhëzimit nr. 29, datë 10. 09. 2018 citon se : "Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik në institucionet e arsimit të lartë, pika 1, "Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë".

Në relacionin e administratorit gjenden të gjitha shkresat justifikuese, ku është marrë miratimi i drejtuesve të njësive përkatëse si dhe relacioni i drejtorisë së ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, e cila ka certifikuar shpërndarjen e këtyre orëve.

Administratori në shkresën e tij citon se, nesë do të kishte të punësuar staf më kohë të caktuar për të mbuluar këto orë suplementare, efekti financiar do të ishte gati 7 herë më i lartë në kosto se përballimi nga stafi i brendshëm i UV, si dhe pagesa e këtyre orëve suplementare



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

është planifikuar në buxhetin e miratuar në vitin 2019 si fond për pagesën e pagave edhe pse mund të ketë ndryshime në shpërndarjen e këtyre orëve.

Pavarësisht se BA konstaton se ka njësi bazë në të cilat janë ngarkuar deri në 100 orë shtesë në auditor (si rast specifik) mbi 200 orëshin e mbingarkesës, pothuasje i gjithë stafi akademik anëtarë të kësaj njësie, BA nuk mund ti hyj llogjikës nëse mund të konsiderohet kjo situatë si raste specifike apo situatë e përgjithëshme, pasi në bazë të parashikimit të mësipërm të Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, ky vlerësim dhe përgjegjësia i përket drejtuesve të njësisë bazë dhe atyre të njësive kryesore.

Bordi i Administrimit vëren se ka një mbingarkesë shumë të madhe të stafit akademik dhe kjo është më tepër e theksuar tek Fakulteti i Ekonomisë, i cili ka përkatësisht 2454 orë dhe kjo për arsye të numrit të lartë të studentëve dhe numrit të vogël të stafit që mbulon realizimin e këtyre orëve, si dhe mosrealizimi i marrjes së stafit të jashtëm si pasojë e mosplotësimit të kriterëve të punësimit. Gjithashtu vihet re se, ka raste ku mbingarkesës në auditor 200 orë, plus 100 orë si rast specifik i shtohet dhe ngarkesë e pagueshme si orë jashtë auditorit në ndihmë të procesit mësimor (praktika, udhëheqje teza diplomash etj), duke krijuar një situatë ku pedagogë tejkalojnë me 2 apo 3 fish ngarkesën normale të parashikuar nga Udhëzimi nr. 29, datë 10.09.2018, ndërkohë që ka ekzistuar mundësia e një shpërndarje më të drejtë të mbingarkesës brenda njësive baze, në të cilat rezulton se ka staf akademik më një mbingarkesë të ulët.

Nisur nga ky fakt me qëllim mospërsëritjen e kësaj situatë dhe uljen e efekteve financiare, Bordi Administrimit pa ndërhyrë në kompetencat e organeve të tjera dhe pa hequr dorë nga përgjegjësia e tij, por duke marrë në konsideratë se kjo situatë mund që në të ardhmen të çënojë qëndrueshmërinë financiare të Universitetit, rekomandon që:

1. Të shihet mundësia e marrjes së stafit të ri si pedagog të jashtëm, e cila do të ulte ndjeshëm reduktimin e orëve të mbingarkesës dhe do të kishte një efekt financiar më të ulët.
2. Krijimin pranë njësive kryesore dhe Rektoratit, të një mekanizmi kontrolli për sa i përket përlllogaritjes së ngarkesës në fillim të vitit konform me programet akademike të miratuara, dhe realizimit të saj përgjatë vitit.
3. Krijimin e një mekanizmi dhe vendosjen e filtrave të duhur nëpërmjet drejtuesve të njësive kryesore dhe bazë, përgjegjësve të seksioneve përkatëse si dhe drejtorive përgjegjëse në Rektorat, për kontrollin dhe shpërndarjen e orëve dhe mbingarkesës në auditor dhe jashtë auditorit, në mënyrë sa më të balancuar tek të gjithë pedagogët, duke evituar tejkalimin e orëve të cilat udhëzimi parashikon qartësisht, dhe duke ruajtur në këtë mënyrë cilësinë në mësimdhënie.



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nga sa u parashtrua mësipër, në përfundim BA në mbledhjen e datës 17. 10. 2019,

VENDOSI:

1. Të pranojë propozimin e ardhur me shkresën nr. 1241/1 prot, datë 08.10.2019 për likuidimin e orëve suplementare për vitin akademik 2018- 2019.
2. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga Buxheti i Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë.
3. Të ngarkojë sektorin e Auditit, për të kryer verifikimet e duhura nëse ka raste ku tejkalimi i mbingarkesës ka ardhur si rrjedhojë e tejkalimit të detyrimit të numrit të lëndëve semestrale të cilat duhet të zhvillohen në një vit akademik, parashikuar në pikën 6 të Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
5. Bashkëlidhur këtij vendimi vendoset një kopje e shkresës nr. 1241/1prot, datë 08. 10. 2019 si dhe gjithë dokumentacioni shoqërues.

Dr. Ervis Mocka - Kryetar

Anjeza Shiko – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Dr. Marinela Muço - Anëtar

